Mbulimi do te behet ne menyre te tille qe te mos mbetet apo te akumulohet uje ne pjese e pambushura ose kanalet pjeserisht te mbushura. Materialet e depozituara ne kanalet e rrugeve ose ne rruge te tjera ujore qe nderpriten nga linja e kanaleve do te largohen menjehere pas perfundimit te procesit te mbulimit duke kthyer formen dhe permasat e kanaleve ne gjendjen e meparshme. Drenazhimet siperfaqsove nuk do te nderpriten per kohe te gjate nese nuk do te jete e nevojshme.

2 PERSHKRIMI I MJEDISIT

2.1 Te dhena te pergjithshme

Bashkia e Shijakut ben pjese ne Qarkun e Durrësit ka një popullsi prej 411.194 banorë. Bashkia e Shijakut gjendet në lindje të bashkisë së Durrësit midis: 41°24'20" dhe 41°2'46" gjerësi gjeografike veriore dhe 19°39'10" dhe 19°29'50" gjerësi gjeografike lindore. Sipërfaqja e kësaj bashkie është 100 km² me shtrirje veri-jug 13 km dhe lindje-perëndim 12 km. Kufiri i Shijakut është tokësor dhe ka një gjatësi prej 52 km. Shijaku është i vendosur në fushën e Shijakut, pjesë e fushës së Durrësit dhe në disa kodra të ulta. Kufizohet me bashkinë e Durrësit në veri dhe perëndim, me bashkinë e Tiranës në jug, me bashkinë e Vorës në lindje dhe bashkinë e Krujës në verilindje. Në përbërje të bashkisë Shijak janë 4 njësi administrative: Shijaku (7 km²), Gjepalaj (42 km²), Xhafzotaj (21 km²) dhe Maminasi (33 km²).


Në hartën e mëposhtme paraqitet shtrirja hapësinore e njërive administrative të bashkisë Shijak.



Harta 1.Njesia administrative Bashkia Shijak


Qarku/Prefectures	2018		
	Burra/Men	Gra/Women	Gjithsej/Total
Berat	64271	63160	127431
Dibër	63083	57895	120978
Durrës	146979	142649	289628
Elbasan	140096	138451	278547
Fier	151735	146409	298144
Gjirokastrë	31109	31843	62952
Korçë	105080	105098	210178
Kukës	39677	37717	77394
Lezhë	63600	63200	126800
Shkodër	100857	104137	204994
Tiranë	436917	447079	883996
Vlorë	95205	94077	189282

Tabela 1. Popullsia sipas Qarqeve dhe gjinise¹



Grafiku 1. Popullsia e Qarkut Durrës

Shkalla e punësimit për meshkujt është 62,8 %, ndërsa për femrat 49,6 %. Shkalla e punësimit të të rinjve është 32,5 %. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e katërt 2016, shkalla e punësimit është 67,8 %



Grafiku 2. Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç²

¹ (www.instat.gov.al)

Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i katërt i vitit 2015 në tremujorin e katërt të vitit 2016, është 5,8 %. Në terma vjetorë, rritja e punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë është: 7,4 % në sektorin e shërbimeve, 5,1 % në sektorin e industrisë dhe 4,5 % në sektorin e bujqësisë. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, në tremujorin e katërt 2016, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart pësoi një rënie prej 1,4 %. Ulja e punësimit në aktivitetet bujqësore vlerësohet të jetë 2,4 %, dhe në sektorin e industrisë 1,8 %. Ndërsa punësimi në sektorin e shërbimeve ka mbetur thuajse në të njëjtin nivel si në tremujorin pararendës.

Qarqet	Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës				Shkalla e punësimit				Shkalla e papunësisë			
	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16
Shqipëria	56,9	57,3	58,5	57,2	47,5	48,4	49,9	49,1	16,6	15,5	14,7	14,2
Berat	58,5	58,8	62,7	58,4	53,3	53,6	57,2	51,9	9,0	8,9	8,7	11,1
Dibër	56,9	54,7	60,4	59,2	52,4	50,3	55,6	53,9	8,0	8,1	7,9	8,9
Durrës	55,5	53,6	53,6	53,3	46,5	45,7	45,2	46,3	16,1	14,7	15,6	13,2
Elbasan	63,8	66,8	68,3	67,2	55,4	57,2	59,8	58,5	13,1	14,4	12,4	12,9
Fier	61,6	62,8	63,2	63,0	53,4	54,9	54,7	54,5	13,3	11,9	13,5	13,5
Gjrokastër	63,1	62,0	57,6	56,7	52,4	53,4	50,3	51,0	17,1	13,8	12,7	10,0
Korçë	55,0	54,1	57,9	52,3	50,0	48,7	52,9	48,3	8,9	9,9	8,6	7,7
Kukës	45,9	48,3	55,8	54,5	37,1	39,3	46,7	46,7	19,0	18,7	16,3	14,3
Lezhë	54,3	56,1	56,8	55,8	45,4	48,1	48,3	47,8	16,4	14,3	14,9	14,5
Shkodër	58,5	59,5	57,6	57,3	50,7	51,3	51,6	49,5	13,4	13,9	10,4	13,6
Tiranë	53,5	53,0	54,4	53,6	41,2	42,6	43,8	44,5	23,0	19,5	19,5	16,9
Vlorë	59,3	62,1	60,2	58,4	43,7	45,7	46,4	44,9	26,3	26,4	22,9	23,1

Tabela 2. Treguesit e tregut të punës sipas qarqeve³

Qarqet	Bujqësi				Industri				Shërbime			
	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16	Tr1.16	Tr2.16	Tr3.16	Tr4.16
Shqipëria	40,7	40,4	40,1	39,7	19,1	19,1	19,6	19,5	40,1	40,5	40,3	40,8
Berat	65,8	62,8	61,3	59,2	14,8	17,7	18,9	16,7	19,4	19,5	19,8	24,1
Dibër	70,9	73,3	68,6	64,5	7,5	7,0	11,5	12,7	21,6	19,7	20,0	22,8
Durrës	25,0	20,6	20,7	23,5	34,7	35,5	35,7	35,4	40,4	43,9	43,6	41,1
Elbasan	63,2	65,4	65,8	63,9	12,5	10,3	9,8	10,0	24,3	24,4	24,4	26,2
Fier	65,1	60,6	58,9	63,7	9,8	11,8	11,9	9,8	25,1	27,7	29,2	26,5
Gjrokastër	40,3	44,0	47,1	47,2	20,9	27,2	27,7	21,0	38,9	28,8	25,2	31,7
Korçë	58,5	58,6	59,3	57,7	14,0	10,1	10,3	14,0	27,6	31,4	30,4	28,3
Kukës	68,4	72,0	73,0	66,7	5,1	6,3	7,9	10,3	26,5	21,7	19,1	22,9
Lezhë	35,7	36,7	40,8	40,1	18,3	17,8	19,0	20,3	46,0	45,5	40,2	39,6
Shkodër	48,4	50,6	49,2	44,4	17,8	16,5	17,8	21,5	33,8	32,9	33,0	34,0
Tiranë	4,7	6,5	4,2	6,1	25,7	26,6	27,1	25	69,4	66,9	68,7	69,0
Vlorë	23,7	22,4	25,2	26,8	28,5	25,7	25,3	26,6	44,2	51,9	49,5	46,2

Tabela 3. Struktura e punësimit sipas sektoreve kryesore të ekonomisë⁴

² Burimi (www.instat.gov.al) Tregu i Punës 2016)

³ Burimi (www.instat.gov.al) Tregu i Punës 2016)

⁴ Burimi (www.instat.gov.al) Tregu i Punës 2016)

2.2 Mjedisi biologjik dhe fizik

2.2.1 Flora dhe Fauna

Ne zonen e shfrytëzimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Zona është e mbuluar në përgjithësi me barishte, shkurre mesdhetare dhe nga bimësi e lartë.

2.2.2 Bimësia tokësore

Burimet pyjore janë të gjithë elementet natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut. Territorët e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në katin fito-klimatik të shkurreve mesdhetare (makje-shibjaku) dhe të dushqeve. Fizionomia e bimësisë së kësaj zonë karakterizohet kryesisht nga shkurre gjithmonë të blerta dhe pjesërisht nga shkurre që i lëshojnë gjethet gjatë stinës së dimrit. Nga shkurret me gjethë gjithmonë të blerta, që bëjnë pjesë në ndërtimin e makjes, më karakteristike janë: mareja (*Arbutus unedo* L.) mërsina (*Myrtus communis* L), xina (*Pistacia lentiscus* L), shqopa (*Erica arborea* L.), gjëneshtër (*Spartium junceum* L.), dafina e egër (*Laurus nobilis*) etj. Mareja (*Arbutus unedo* L.), është një bimë shkurrore me lartësi deri në 10m, me një ose disa degë. Mërsina (*Myrtus communis* L), është një bimë shkurrore që gjendet në territorët e Durrësit dhe të Shijakut. Xina (*Pistacia lentiscus* L), njihet edhe me emri Liqe (në Ishëm). Xina është një shkurre me shumë degë që rritet zakonisht prej 1 deri në 4 m. Lëvoren e ka të murme, degët e reja i ka me push dhe në ngjyrë gështenjë, kurse gjethet i ka çifte të pupluara dhe lulet e vogla të kuqërremta. Fryti është një kokërr e kuqe, që kur piqet merr ngjyrë të zezë. Shqopa (*Erica arborea* L.), është bimë shumëvjeçare që rritet deri në lartësinë 6 metra. Degët e reja i ka të bardhëreme e me push, gjethet lineare dhe lulet e bardha me ngjyrë trëndafili me pak erë. Gjëneshtër (*Spartium junceum* L.), është një shkurre e vogël që rritet rregullisht prej 1 deri në 2 m lartësi. Degët i ka të holla e të gjata me disa gjethë të rralla. Gjethet i ka të vogla, kurse lulet të verdha e të mëdha me erë të këndshme dhe të grumbulluara në majë të degëve. Në zonën e RrushkullHamallajt gjendet një brez i ngushtë i pyjeve halorë mesdhetare me specie dominante: Pishë bregdetare (*Pinus pinaster*), Pishë e egër (*Pinus halepensis*) dhe rrallëherë Pishë e butë (*Pinus pinea*), e kultivuar 40 – 50 vjet më parë për stabilizimin e dunave ranore dhe mbrojtjen e tokave bujqësore¹⁴³. Vidhi (*Ulmus foliacea*), është një dru i bukur që rritet deri në 30-40 m lartësi. Lëvoren e ka mjaft të çarë dhe me ngjyrë hiri, gjethet janë me bisht të shkurtër, lulet pothuajse pa bisht, kurse fruti është aken i rrumbullakët dhe i fllashkët i rrethuar prej një cipe të hollë. Gjendet në Hamallë dhe Sukth. Rrapi (*Platanus orientalis*), është dru deri në 40m lartësi, me lëvore të bardhë që ndahet pllaka-pllaka. Gjendet në zaje të lumit Erzen. Një nga rrapet më të veçanta është “Rapi i Rubjekës”, që ndodhet në fshatin Rubjekë (njësia administrative Maminas), i cili mban statusin e biomonumentit. Ky rrap, i cili është një dru rreth 17 m i lartë, me diametër të trungut 7 m dhe moshë 500-600-vjeçare, ka vlera shkencore dhe biologjike, prandaj është pjesë e Zonave të Mbrojtura në vendin tonë. Shelgu i bardhë (*Salix alba*), është dru deri në 20-22 m, me lëvore të përhimtë dhe degë të shumta të shpërndara dhe majëvarura. Lulëzon në mars-prill. Përdoret si lëndë ndërtimi dhe për objekte dhe vegla pune. Shelgu i kuq (*Salix purpurea*) është një shkurre deri në 4-5 m. Degët e reja janë hollake, të drejta, shogëta, të shndritshme, ndërsa gjethet të këmbyera. Plepi i bardhë (*Populus alba*), është dru deri në 30-35 m, me kurrorë të gjerë të rrumbullakosur dhe me lëvore të përhimë të bardhë e të lëmuar. Pisha e detit (*Pinus pinaster*), është një dru deri në 40 m, me lëvore të murme të kuqërremtë, të carrë thellë për së gjati. Degëzat janë të shogëta dhe halat janë dyshe. Boçet janë konike deri

vezëngjashme. Pisha e egër (*Pinus halepensis*), është dru deri në 25 m i lartë, me kurorë të çrregullt dhe me lëvore të çarë thellë. Halat janë dyshe, të buta dhe me ngjyrë të blertë të çelët. Boçet janë të murrme dhe të shndritçme. Pisha e butë (*Pinus pinea*), është dru deri në 28-30 m lartësi, me kurorë ombrellore dhe me lëvore të murrme të përhimë, të çarë thellë që rripet pllaka-pllaka. Halat janë dyshe, majëmprehta dhe të forta. Boçet pothuajse janë pa gjemba.



Figure 1. *Pinus pinaster* *Festuca*

Si shoqërues i katit shkurror dhe pyjor është mbulesa bimore, kryesisht e tipit umbrofil. Shoqërizimet kryesore bimore të zonës janë: Fieri (*Petris aquiliana*), Lisna ose Timusi (*Thymus vulgaris*), Shelgu i Bardhë (*Salix alba L.*), Telishi (*Dactylis glomerata*), Vicia (*Vicia Dasycarpa*), Menishtet (*Cistus salvifolius*), *Festuca* (*Festuca varia*), Teukli (*Teocrium polium*), Bocka (*Urginea maritima bok*), Tërfile (*Trifolium pratense*), Shpendra (*helleborus edours*), Lule shqerra (*Bellis perennis*), Geranium (*Geranium pyrenacium*), Barbstari (*Sanguisorba officina*), Ban i bletës (*Meishema officinalis*), Hedera (*Hedera helix*), Qumështorja (*Euphorbia cuparisias*), Hithra (*Urtica dioica*) Mellaga (*Althaea officinalis*) etj. Hithra (*Urtica dioica*), është bimë shumëvjeçare rreth 30-150cm, me kërpeç zvarritës, e mbuluar dendësisht me qime djegëse. Hithra rritet në toka të pasura azotike. Mëllaga (*Althaea officinalis*), përdoren gjethet si burim ushqimi dhe në mjekësi për të luftuar çrregullimet në sistemin e frymëmarrjesd dhe tretjes. Shelgu i Bardhë (*Salix alba L.*), rritet deri në 30 m i lartë dhe deri në 1 m i trashë. Lëvorja e tij është e çarë për së gjati dhe me ngjyrë hiri, ndërsa degët i ka të varura poshtë në ngjyrë ulliri. Shelgu lotues gjendet pranë lumenjve Erzen dhe Ishëm dhe në fushën e Shijakut. Në këto territore rritet bimë mjekësore dhe aromatike si: Mimoza (*Acacia dealbata*), Petriku kulper (*Aristolochia clematitis*), Pelini i Zi (*Artemisa vulgaris*), Minuri si pelin deti (*Chenopodium ambrisiodos*), Menishtja me push (*Cistus incanus*), Ekualipti rruazor (*Ecualiptus glopulus*), Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Fidhësi (*Juniperus communis*), Dafina (*Laurus nobilis*), Mëllaga (*Malva silvestris*), Rigoni i Bardhë (*Origanum vulgare*), Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Majdanoz (*Petroselinum sativum*), Pisha e butë (*Pinus pinea*), Trumza (*Saturea montana*), Bar majasëlli (*Teucrium polium*), Matriku (*Vinca major*) dhe Konopica (*Vitex agnus-castus*). Petriku kulper (*Aristolochia clematitis*), është bimë barishtore shumëvjeçare e shogët, me erë të keqe. Rritet në vendet me bar, të lëna djerrë dhe shkurreve. Petriku kulper është bimë mjekësore. Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), është bimë njëvjeçare rreth 25-90 cm, e grathët, me qime të hapura e me kërcej të degëzuar. Rritet në vende me bar. Lulëkuqja është bimë e helmët dhe mjekësore. Pjesa tjetër e bimëve mjekësore dhe aromatike janë pjesë e librit të kuq.




Figure 2 .Mbulesa bimore në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut

2.2.3 Fauna

Fauna e tokës

Bota shtazore e Durrësit është e shumëllojshme, në varësi edhe të tërësisë së habitateve tokësore e ujore që gjenden në këto territore. Në grupin e faunës tokësore bëjnë pjesë gjitarët e tokës (mishngrënës dhe barngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të bashkive Durrës dhe Shijak, janë pothuajse të ngjashëm me ato të të gjithë Shqipërisë dhe mbarë Mesdheut. Pavarësisht dëmtimeve nga dora e njeriut, fauna e këtyre territoreve është e ende e pasur. Përfaqësues i gjitarëve të tokës është lepuri i egër (*Lepus europaeus*, Pall, L. *Capensis*, L) dhe ketri (*Scirus Vulgarus*, L.). Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut janë të pasura me lloje të shumta shpezësh të tokës dhe ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në mënyrë të përhershme e si të tillë, ata janë sedentarë. Por ka edhe një numër të madh shpendësh, të quajtur shtegtarë, që vijnë nga viset e Europës Veriore për të kaluar dimrin në këto territore. Disa të tjerë e kalojnë tek ne muajin e verës, ndërsa në dimër

zbrasin në viset më të ngrohta të Afrikës Veriore dhe Qëndrore. Kemi dy grupe shpendësh, ato që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegëtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e këtyre bashkive janë tushat, laureshat etj; nga rendi i harabelave (Passeriformes); rosat e patat nga rendi i patorëve (Anseriformes); disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër (Colmbiformes); nga rendi shapkave dhe i gjelzave të ujit (Charadriiformes) etj. Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, sic janë bilbilat (*Lucinia megarhyncha*), bilbilthas (gjinia *Sylvia*), bishtatundësit (gjinia *Motacilla*), dallëndyshit, bengat etj., ndërsa nga rendet e tjera shkurtat, turtujt etj. Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë, por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në ujërat bregdetare. Ato janë të familjes së rosave, patave (Anatidae), të shapkave (Scrolopacidae) etj. Në grupin e shpezëve të ujit bëjnë pjesë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*, L), Shkurta (*Coturnix coturnix* L) etj. Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur me lloje dhe ekzemplarë. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat. Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme (*Testudo hermanni* Gmel). Gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Përhapje të gjërë kanë ata johelmues si: Shigjetat (*Coluber gemonensis*, C. *Najadum* e C. *Jugularis*) dhe disa bolla, si bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*) dhe bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*). Nga gjarpërinjtë helmues më i rrezikshmi është nepërka e zakonshme (*Vipera ammodytes*). Hardhucat më e përhapur është hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*) dhe zhapiku i gjelbër (*Lacerta viridis*, L), që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra.



Fauna ujore

Kompleksi faunor i ujërave të ëmbla është mjafti pasur. Ai përfaqësohet nga peshq, moluskë (butakë), gastropodë, bivarvorë, këmbënyjtorë, gamrra, insekte ujore etj. Shpesh në Ujërat e ëmbla përfshihen edhe kafshë të tjera si shpenë, amfibë e ndonjë gjitar, siç është lundërza (vidra). Fauna e ujërave të ëmbla përfshin faunën e lumenjve, të rezervuarëve, të kanaleve ujore në territorin e rrethit të Durrësit. Ujërat detare në bregdetin e Durrësit janë mjaft të pasura me lloje të ndryshme peshqish, zvarranikësh, molusqesh etj. Në faunën e ujërave bregdetare dallohen si format vendase (autoktone), siç janë levreku, qefulli, koca, spalci, dentali (sinagridha) ashtu edhe ato migratore, si stavridi, toni, shpata etj. Nga vertebrorët rëndësinë dhe përhapjen më të madhe në sasi dhe

shumëllojshmëri e kanë peshqit, të cilët përfaqësohen nga lloje të shumta e me rëndësi industriale siç është sardelja (*Srdina pilchardus sardina*). Peshq të tjerë janë qefulli (*Mugli cephalus* e lloje të tjera), i cili gjendet në Ujërat bregdetare të Durrësit, por sidomos në grykëderdhjet e lumit Erzen dhe Ishëm, nëpërmjet të cilave futet edhe në rrjedhjet e poshtme të tyre. Në ujërat bregdetare të Durrësit rriten edhe peshq më të mëdhenj si toni (*Thunnus thunnus*) me rëndësi industriale, pelamidi (*Sarda sarda*), që ngjan shumë me tonit etj. Nga jovertebrorët, në ujërat e bregdetit të Durrësit takohen me shumicë moluskë (butakë), sfungjerë, celenteratë, lëkurëgjemborë (ekinoderma) si iriq, yje, zambakë deti etj. Nga gastopodët rriten patelat (*Patella*), muresket (*Murex*) etj. Nga krustacët rriten karkalecët e deti (*Panaeus*). Në ujërat detare rriten dhe mjaft zvarranikë, si breshka, gjarpërinj uji etj. Të gjitha bimët dhe kafshët e përmendura më sipër, të cilat kanë vlera përdorimi konsiderohen resurse të biodiversitetit. Veçoritë dhe karakteristikat e tyre do të përshkruhen në kapitullin e dytë. Pozita gjeografike e bashkisë Durrës në gjerësitë gjeografike mesatare, pothuajse në qendër të vendit tonë dheme dalje të gjerë në bregdetin e Adriatikut, ka mundësuar kushte natyrore të përshtatshme në krijimin e shumëllojshmërisë së resurseve natyrore. Depozitimet e periudhës gjeologjike tortonian-kuaternare kanë mundësuar praninë e resursit mineral jometalor të qymyrgurit, naftës dhe gazit natyror, si dhe materiale ndërtimi të ndryshme. Format e veçanta të relievit të krijuara nga veprimtaria e valëve detare dhe erës, janë pjesë e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe mund të konsiderohen si resurse gjeomorfologjike. Klima mesdhetare fushore, e nënzonës qendrore mundëson pasuri të pashtershme drite, ngrohtësie dhe lagështire. Rrjeti hidrografik i pasur me ujra të kripura dhe të embla, përbën një burim të madh ujqor, me vlera të shumëllojshme përdorimi. Kushtet natyrore të Durrësit dhe të Shijakut kanë mundësuar praninë e 7-të lloje tokash në një sipërfaqe prej 432 km². Bota bimore dhe shtazore ka përhapje të gjerë në tokë dhe në ujë, në lartësi të kodrave, në fushën e Durrësit dhe në zonën bregdetare të Adriatikut dhe përbën një nga burimet e natyrës më të përdorur.

2.3 Kushtet hidrogeologjike

2.3.1 Ujërat e lumenjve (Erzen dhe Ishëm)

Rrjeti hidrografik lumor, i dy bashkive, dallohet për dendësi të madhe, deri në 3 km/km². Të dy lumenjtë konsiderohen të shkurtër, me pellgje ujëmbledhës të vegjël dhe shkallë ujëshmërie të ulët. Gjatësia e përgjithshme e lumit Erzen është 105 km dhe e lumit Ishëm 79.2 km. Pellgu ujëmbledhës i të dy lumenjve është 1433km². Erzeni buron në afërsi të qafës së Gurakuqit, rreth 1300 m mbi nivelin e detit, ndërsa Ishmi buron nga vargjet malore të Skënderbeut. Shkalla e ujëshmërisë në të dy lumenjtë ka karakter stinor dhe lidhet me regjimin klimatik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit dallohen prurjet maksimale (plotat) dhe gjatë periudhës së verës evidentohen prurjet minimale ose pakat. Dallime vihen re edhe midis stinëve të vitit. Në stinën e pranverës ka më tepër prurje se në vjeshtë, pavarësisht se në vjeshtë ka më shumë reshje shiu apo bore në pellgun ujëmbledhës. Prurjet më të mëdha janë në pranverë dhe kjo lidhet me shkrirjen e dëborës dhe me tokën e lagur e të ngopur me ujë nga stina e dimrit. Koeficienti i rrjedhjes së lumenjve është i lartë, përkatësisht Ishmi (0.68%) dhe Erzeni (0.51%), çka do të thotë se më tepër segjysma e sasisë së reshjeve që bie në pellgun ujëmbledhës të lumenjve hyn në rrjedhje. Sasia e ujit të grumbulluar në 1 km² ose moduli i rrjedhjes është i ndryshëm për të dy lumenjtë. Në çdo 1 km² të pellgut ujëmbledhës të Ishmit

mblidhen rreth 31 l/sek, kurse në pellgun ujëmbledhës të Erzenit rreth 25 l/sek. Sasia e ujit që kalon në shtratin e lumit përfaqëson prurjen e lumit dhe në lumin Erzen është 20m³/sek, ndërsa në Ishëm 18 m³ /sek. Të dy lumenjtë kanë rregjim torrencial të lartë (rregjim me luhatje të mëdha midis prurjeve ekstreme dhe mesatare). Pavarësisht se lumenjtë Ishëm dhe Erzen janë ujëpak, ata konsiderohen si lumenj që transportojnë sasi më të mëdha të materialeve të ngurta, në vendin tonë⁴⁹. Dallohet për rrjedhje shumë të vogël (minimale) dhe rrjedhje të madhe të ngurtë me prurje 102 kg/sek, turbullira 5610 gr/m³ dhe modul të rrjedhjes së ngurtë 5310 ton/km²/vit.

2.3.2 Ujërat nëntokësore

Zona nuk cilesohet e pasur me ujëra të cekta nëntokësore. Këto ujëra rrezikojnë të ndoten nga prania në zonën e kënetës të vendgrumbullimit të mbetjeve, nga ndotja e mëparshme e mjedisit dhe tokës në zonën e lindanit dhe të bikromateve, nga ish fabrika e prodhimit të kimikateve me bazë sulfuri si dhe nga ekzistenca e një vend grumbullimi mbetjesh kimikatesh si pasojë e reshjeve të shumta.

- Burimet kryesore të ndotjes janë dhe mbetjet urbane (mbetje inerte dhe të lëngshme). Ndotja e ujit urban ndodh nga prania e P (fosforit) që e ka burimin nga detergjente të ndryshëm që përdoren kryesisht prej familjeve. Nitratet (Azotet) janë një tjetër element ndotës i gjendur në ujë, në formën e NO₂ dhe NO₃, që vjen prej aktiviteteve urbane, bujqësore dhe industriale. Ndotja më e madhe e ujit është ndotja mikrobiologjike që shkaktohet nga ujërat e zeza dhe që përfundojnë pa trajtimin e tyre, në lumenj dhe në forma të tjera në anë të rrugëve dhe kanaletnatyrore të drenazhimit dhe përfundimisht derdhja e tyre në det.

Duke u bazuar në kriterin litologo-stratigrafik, veçohen dy komplekse kryesore ujëmbajtëse:

- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të shkriфта Kuaternare (Q4);
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve molasike të përfaqësuara nga konglomeratët dhe ranorët e suitës Rrogozhina dhe ranorët e Miocenit të Sipërm.

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të shkriфта Kuaternare

Ky kompleks ujëmbajtës përhapet në të gjithë rajonin e studiuar si në njësinë gjeomorfologjike bregdetare ashtu dhe në atë detare. Simbas ujë përshkueshmërisë dhe ujëmbajtjes, brenda këtij kompleksi dallojmë këto horizonte ujëmbajtëse:

Horizonti ujëmbajtës i rërave bregdetare, me përshkueshmëri mesatare deri të vogël, me përhapje të gjerë në të gjithë brezin bregdetar me dune të zhvilluara, me ujëmbajtje në përgjithësi të vogël.

- Horizonti ujëmbajtës i rërave lagunore-kënetore me përhapje të kufizuar, me përshkueshmëri dhe ujëmbajtje të vogël.
- Horizonti ujëmbajtës i rërave dhe i surerave aluviale me përhapje në të gjithë njësinë fushore, me një përshkueshmëri mesatare deri të vogël dhe ujëmbajtje të vogël. Të tre horizontet e lartpërmendur kanë ujëra pa presion.
- Horizontet ujëmbajtëse me presion të zhavorrëve aluvialë me përshkueshmëri të lartë, përhapje të gjerë në të gjitha luginat lumore të rrjedhjes së poshtme dhe me ujëmbajtje të madhe.

Për qëllime ndërtimore, rëndësi marrin horizontet e ujërave pa presion, që përbëjnë për çdo shesh horizontin e parë ujëmbajtës nga sipërfaqja e tokës (horizonti i rërave detaro-lagunore ose aluviale), ndërsa për qëllime furnizimi me ujë të pijshëm të qyteteve, industrisë dhe vaditje, marrin ujr

nëntokësore të thella të konglomeratëve të suitës Rrogozhina.




Figure 3. Harta e perdorimit te tokes

Gjeologjia

Gjeomorfologjia

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi actual. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne zonen e studjuar. Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane

1. Fenomeni i erozionit
2. Fenomeni i levizjes se mbuleses deluvialo eluviale ne shpatet e kodrave
3. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluvialo-lagunore
4. Masat inxhinierike per permiresimin e themelet te rruges se re
5. Masat inxhinierike per stabilitetin e shpateve ku do te kaloje rruga e re

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje me poshte:

1. Fenomeni i Erozionit eshte i dukshem ne pjesen shpatore te kodrave ku kalon rruga e re. Rrymat e ujrave siperfaqesore qe grumbullohen ne periudhen e reshjeve massive gerryejne pjesen e perajruar te formacionit rrenjesor dhe materialin e transportojne ne pikat me te ulta te relievit. Trupi i rruges dhe themelet e urave jane ne pjesen e mesit te lugines; ai eshte i ekspozuar nga ky fenomen. Ekziston mundesia e veprimit negativ te erozionit ne trupin e rruges, ne lidhje me kete duhet te tregohet vemendje te mbrohet traseja e rruges qe eshte ne germim dhe ne mbushje nga rreziku i gerryerjes se saj. Per kete rekomandojme largimin e ujrave ne te dy pjeset e saj me anen e

kanaleve te cilat duhet te drejtojnë ujin tek urat ose veprat e tjera hidraulike. Themelet e urave dhe te tombinove duhet te mbrohen nga ky fenomen negativ.

2 Fenomeni i levizjes se mbuleses deluvialo eluviale ne shpatet e kodrave eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga sedimentare qe jane argjilte, ranore dhe konglomeratet qejane depozitime te reja dhe me cimentim te dobet argjilor. Keta shkembinj nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet ne pjesen shpateve te kodrave qe ndertohen nga keto shkembinj. Nga fshati Karpen deri ne fund te rruges fshati Likesh. Formacionet qe ndodhen ne kete shpat shperbehen dhe si rezultat i kesaj bien ne rruge materiale, rekomandojnie qe skarpatat te mbrohen me shtrese te holle betoni ose me rrjete teli

3. Fenomeni i levizjes se mbuleses deluvialo e luviale ne shpatet e kodrave ky fenomen negativ gjeodinamik nuk eshte i pranishem gjate gjithë segmentit rrugor por ne disa pjese te vecanta te tij ne ato pjese ku rruga kalon ne pjesen shpatore te kodrave nga Karpen deri ne Likesh, ai nuk eshte nje kercenim evident per rrugen e re por ne disa pika te vecanta duhet te merren masa per te mbrojtur rrugen nga levizja e ketyre masave. Rreziku me i madhe eshte kur te filloje ndertimi I rruges sepse mund te aktivizohen masa te reja nga germimet dhe mbushjet e turpit te rruges. Ne rekomandojme qe te gjitha germimet me lartesi mbi 3.00m te mbrohen me masa inxhinierike. Per cdo mbushje me lartesi mbi 3.00m duhet qe te merren masa inxhinierike per stabilizimin e saj ne rastin ku mbushja eshte ne shpat te pjerrtet.

4. Konsolidimi i depozitimeve aluvialo lagunore

Keto depozitime perbehen nga shtresa suargjilash, surerash, rerash, argjilash me permbajtje lendesh organike dhe shtresa torfi. Ne keto pjese te fushes se Shijakut qe jane krijuar nga depozitimet lagunore ne meandrimet e lumit Erzen jane prezente depozitimet lagunore nderthuren me depozitimet detare te ujrave te qeta dhe te perrejve te zones. Ne keto kushte jane depozituar materiale me granulometri te imet dhe lende organike. Shtresat qe permbajne lende organike jane te pakonsoliduara ose pak te konsoliduara. Nga vrojtimet e kryera ne vend duken qarte prezenca e ketyre depozitimeve te cilat kane ndikuar negativisht ne objektet qe jane ndertuar mbi keto depozitime sic jane deformime te trupit te rrugeve ekzistuese, carje te niureve te godinave.

5. Masat inxhinierike per permiresimin e themelit te rruges se re sikurse e permendem me siper rruga e re do te mbeshtetet mbi depozitime me karakteristika te dobta fiziko mekanike, te derformueshme per te realizuar nje trupin te rruges se re te qendrueshem per nje kohe te gjate ne rekomadojme te merren masat e meposhtme:

a. Te hiqet toka vegjetale e cila eshte me trashesi 30-40cm dhe kjo te zevendesohet me nje shtrese gjeotekstili

b. Te shtrohet nje shtrese rera rreth 15cm mbi gjeotekstilit ajo duhet te ngjishet me rrul me peshe 10-15ton pa vibrim

c. Te shtrohen disa shtresat e tjera granulare me trashesi 25cm deri sa te realizohet nje trashesi mbushje 1.80-2.00m

d. Materilet duhet te plotesojne kushtet - granulometria nga 0.00-70mm, prania e materilit argjilor me pak se 5%, treguesi i plasticitetit te jete me i vogel se 10, treguesi i CBR te jete me i madh se 20%.

e. Ngjeshja duhet te kontrollohet dhe te kete realizuar me shume se 95% e ngjeshjes se arritur ne laborator.

f. Lartesia e mbushjes duhet te jete me e madhe se 1.50m mbi nivelin maksimal te ujit siperfaqesore.

Por ka dhe nje menyre tjeter te permiresimit te themelit te rruges e cila eshte duke perdorur teknologjine Powercem ose roadcem, kjo teknologji eleminton heqjen e tokes vegjetale dhe perforcimin me shtresa granulare, ajo ben cmimetimin e shtresave te tokes natyrore qe kap nje modul deformacioni 100-150Mpa dhe mbi kete shtrese te perforcuar hidhen shtresat e struktures se rruges. Kjo teknologji eshte perdorur ne Fier dhe ka dhene rezultate shume te mira.

Kushtet Hidrogeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen nga Karpen deri ne Likesh te Bashkise se Shijakut (nga matjet e kryera ne shpimet dhe ne gropat) rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndrysheni. Sipas perberies hidrogeologjike ne kemi vecuar dy komplekse Hidrogeologjike te cilat po i pershkruajme me hollesish me poshte:

Kompleksi ujembajtes i shkembinjve te shkrijet

Kompleksi ujembajtes I depozitimeve te shkrijet perfaqeson depozitimet aluvialo proluviale te fushes nga Karpen deri ne Likesli. Depozitimet e kuaternarit kane perhapje te madhe nga punimet e meparshme identifikohet nje trashesi e pakos deri ne 40-50m nga siperfaqja e tokes. Vetite e zhavoreve per ujedhenie vleresohen si te mira me $Q > 800m^3/dite$.

Vetite kryesore hidrogeologjike te depozitimeve zhavorore jane: poroziteti i larte dhe lidhja midis tyre, uje pershkushmeria dlle ujedlienia. Kompleksi ujembajtes i shkembinjve kompakte Sipas karakteristikave ne kemi disa lloje shkembore qe kane karateristike te ndyshme hidrogeologjike te cilat po i pershkruajme me hollesisht me poshte. Depozitimet e Neogjenit. Perbehen nga shtresa argjilitesh, ranoresh dhe konglomeratesh. Shtresat e ranoreve dhe te konglomerateve kane pershkushmeri te mire dhe ne keto shkembinj mund te gjenden ujra nentokesore. Shtresat e argjiliteve dhe alevroliteve jane me pershkushmeri te dobet, ato kane ujedhenie te vogel.

Autoret e studimit kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja ne to jane kryer matje ne disa kohe gjete gjithe periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte 0.50-1.00m ne zonen fushore kurse ne zonen kodrinore niveli i ujit eshte -3.0-4.0m. Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra te neutrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit

. Pozicionet e gadishujve te vegjel ne veri dhe ne jug te Gjirit te Lalzit lidhen me strukturat gjeologjike te brezave kodrinor te Ishmit ne lindje dhe te Durres - Porte Romano ne perendim. Keta elemente gjeomorfologjike te rajonit kane rendesi per te gjykuar dhe vleresuar regjimin e vijes bregdetare te Gjirit te Lalzit ne teresi dhe te truallit te kompleksit ne vecanti. Njohja dhe vleresimi i regjimi te levizjes te vijes bregdetare ka rendesi thelbesore per jetegjatesine e kompleksit turistik.

Tiparet gjeomorfologjike te rajonit kane gjithashtu rendesi themelore per te bere vleresimet historike te dukurise se lengezimit dhe te levizjes te vijes bregdetare. Bazamenti erozional i brezit bregdetar te Gjirit te Lalzit eshte me thellesi 20 - 22 m ne truallin e kompleksit dhe perbehet nga shtresa sedimentare kryesisht alevrolitike ranore e me pak konglomerate te suites "Helmesi" me moshe gjeologjike Pliocene (N2h). Shtresat e suites "Helmesi" perbejne gjithe truallin rrenjesor te Gjirit te Lalzit deri ne shpatet perendimore te struktures se Ishmit. Fusha e Hamallajt eshte me

origjine akumulative si terrace bregdetare e Gjirit te Lalzit. Deri ne thellesine 0.5 - 1.5 m terreni fushor perbehet nga suargjila me ngjyre kafe ne gri, ndersa nen ketë thellesi vijojne depozitimet me rera dhe surera te plazhit bregdetar shume te hershem. Thellesia e bazamentit Pliocenik ne brezin bregdetar te Gjirit te Lalzit ka rendesi thelbesore per vleresimet a sjelljes sizmike te trojeve ndertimore.




Figure 4. Harta gjeologjike e zones


Erozioni i tokes

eshte nje problem qe prek gjithe territorin e vendit por ne veçanti ne zonen Tirane- Durres perben problem edhe me te madh.. ky fenomen manifestohet me shkaterrimin e shkembinjve, ku nen ndikimin edhe te shpyllezimeve te cilat jane pergjegjese te shkarjeve te dheut, te avancimit se detit, dhe te humbjes se komponentit organik te lendeve ushqyese prezente ne terren. Erozioni eshte shkak i degradimit te tokes duke sjelle: humbjen e lendeve ushqyese te tokes, qe jane thelbesore per kultivimin e kulturave bujqesore, kjo imponon perdorimin e fertilizuesve, qe vleresohen te jene me shume se 40% ne menyre qe te kompensojn humbjet e ushqyeseve natyrale te terrenit nga erozioni. Ne nivel kombetar kjo perkthehet ne nje humbjeekonomike rreth 98 milion dollar. Ne bashkine e Shijak jane verejtur rreshqitje dhe erozionin e tokes bujqesore, te cilat kontribuojne ne degradimin e matrices tokes se mjedisit

2.3.3 Tokat

Materiali primar. Tokat e Hinjta Kafe formohen ne materiale primare me nature te ndryshme, si proluviale, diluviale, aluviale dhe liqenore. Keto te fundit paraqiten me teksture, perberje

mineralogjike dhe kimike te ndryshme. Depozitimet proluviale ndeshen mjaft rralle dhe vetem ne fundin e shpateve shume te pjerreta te kodrave. Ato jane te paseleksionuara. Depozitimet deluviale vendosen ne pjesen fundore te shpateve te pjerreta te kodrave. Kane ngjyre te hirse ne te verdhe, perberje mekanike subranore e subargjilore, si dhe permbajne karbonate. Pjesa e trashe e tyre



perbehet kryesisht nga kuarci, ndersa pjesa e imet nga hidromikat dhe mineralet e dyta te grupit te montmorilonitit. Pjesa e imet e depozitimeve subargjilore me ngjyre te kuqe perbehet nga hidromikat, caoliniti dhe oksidet e hidratuara te Fe.

Nderimi i profilit Tokat e Hinjta Kafe kane profil te diferencuar ne shkalle te ndryshme. Profili eshte A1-A2-AB-BC-C ose A-AB-B-C ose A-AC-C.

Tokat e Hinjta Kafe Tipike Karakteristikat fizike. Densiteti vellimor shkon 1.02 – 1.51 g/cm³, densiteti specifik 2.63 – 2.75 g/cm³, kapaciteti ujembajte fushor nga rreth 27% ne tokat me teksture te mesme, ne rreth 34 %ne ato me teksture te rende, poroziteti total dhe i ajrimit ne horizontin e pranueshem perkatesisht 52 – 59 dhe 17 – 30.5 %. Plasticiteti i ketyre tokave eshte mesatar.

Karakteristikat kimike. Tokat jane neutrale deri ne lehtesisht bazike (pH uJOR 7.4 – 7.6), me permbajtje mesatare humusi dhe N ne horizontin A (perkatesisht 2 – 3 dhe 0.1 – 0.17 %). Te varfera me P, te pasura me K dhe CaCO₃ dhe te saturuara me baza. Raporti SiO₂/Al₂O₃ eshte 4 – 5 ,ndersa ai SiO₂/Fe₂O₃ eshte 39. Krahasuar me nentipet e tjera, keto toka ne pergjithesi kane cilesi fizike dhe strukture te mire, per shkak te permbajtjes se humusit, CaCO₃ dhe bazave ne kompleksin thithes.

2.4 Sizmiciteti

Zona ne studim perfshihet ne zonen e burimeve sizmike te Ultesires Praneadriatike, te vleresuar me magnitudo maksimale te pritshme te termeteve $M_{max} = 7.0$. Ne kuader te krahines se Shijakut, ku ben pjese, kjo zone i perket njeres prej zonave sizmogene me potencial sizmik te pritshem nga me te Lartet e territorit te Shqiperise. Vlerat e larta te ketij potenciali i detyrohen faktit se gjeografikisht kjo zone ndodhet prane ballit mbihypes te orogjenit Shqiptetar, ne konvergjence me mikroplaken e Adrias. Amplitude e larte e levizjeve shtypese, qe lindin si pasoje e kesaj konvergjence krijon kushte per termite te forta, magnitudo e te cileve arrin potencialisht deri ne $M = 7.0$.

Tektonika dhe Sizmiciteti lokal

Edhe shkeputja kunderhypese, qe prek anen lindore te structures se Durresit, i perket tektonikes pas pliocenike. Kjo shkeputje kalon neper pjesen veriore te antiklinalit te Kryevidhit ne gjirin e Durresit, ne lindje te antiklinalit te Tiranes dhe ne Bishtin e Palles. Fakti qe thyerja e mesiperme prek edhe depozitimet detare kuaternare, tregon qe ajo eshte active edhe ne ditet e sotme.

Aktiviteti tektonik i zhvilluar pergjate shkeputjeve ne pernedim dhe lindje te qytetit te Shijakut dhe nyjeve te nderprerjes se tyre, qendrojne ne origjinen e aktivitetit sizmik te kesaj zone.

2.5 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre

Zona ne fjale nuk ben pjese ne asnje kategori te zonave te mbrojtura dhe nuk mbart vlere kulturore dhe historike per vendi.




Figure 5. Harta e zonave te mbrojtura
(Burimi: www.asig.gov.al)

2.6 Karakteristikat klimatike të zonës

Në bazë të monografisë “Klima e Shqipërisë”, zona e ndërtimit ndodhet në një rajon me klime mesdhetare fushore qendrore. Në këtë zonë, rrezatimi i përgjithshëm diellor vjetor është $R=1611$, 84kWh/m^2 , duke patur një variacion mujor nga 70.61kWh/m^2 në muajin janar, që është muaji me vlerat më të ulta të rrezatimit të përgjithshëm diellor, e cila arrin deri në 214.45kWh/m^2 në korrik, që përkundrazi është muaji me vlerat më të larta të rrezatimit të përgjithshëm diellor. Numri i ditëve me diell është 340 ditë/në vit, ndërsa zgjatja relative e diellëzimit është rreth 60%.

Shtresa mesatare vjetore e reshjeve atmosferike është 980.5mm, duke patur një variacion mujor nga 14.3mm në korrik, që është muaji më me pak reshje i vitit, deri në 152.0mm në nëntor, që përkundrazi është muaji më me shumë reshje. Numri i ditëve me reshje është mesatarisht 110 ditë në vit. Reshjet më të mëdha 24 orëshe, me $p=1\%$ siguri në këtë zonë janë 210mm, ndërsa reshjet të mëdha 12 orëshe me të njëjta siguri janë përkatesisht 167mm, reshjet 6 orëshe 136mm, reshjet 4 orëshe 125mm, reshjet 3 orëshe 119mm, reshjet 1 orëshe 110 mm, reshjet me kohë-zgjatje 30 minuta janë 71mm dhe me kohë-zgjatje 15 minuta janë 45mm.

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonata si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbajtje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura. Si vite skajore në Shqipëri janë përcaktuar vitet hidrologjike 1949, 1954, 1957 e 1985 si vite ujëpakët dhe 1963, 1970, 1978 e 1986 si vite ujëshumë. Ndër ata ujëpakët, më i thati paraqitet viti 1949. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare, në këtë vit sasia e reshjeve kanë qenë 1.6 herë më pak se norma.

Gjatë këtij viti, thatësira ka qenë më e theksuar në Shqipërinë juglindore, si në Voskopojë, Korçë,

Leskovik, etj. I dyti për nga thatësira është viti 1953-1954, me 1.4 herë më pak reshje se mesatarja shumëvjeçare. Viti me reshje më të shumta ka qenë viti 1963, me 1.6 herë më shumë reshje se mesatarja shumëvjeçare në shkallë vendi dhe veçanërisht në zonën jugore me 2 herë më shumë se mesatarja. Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi tepër e vogël reshjesh, rreth 700mm/vit, sasi e cila në vitin 1907 ka rënë në 680 mm/vit, duke përfaqësuar sasinë më të vogël vjetore të reshjeve në Shqipëri. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me $0,7-2,5^{\circ}\text{C}$, pra luhatje e, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik. Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës




Figure 6. Zonat klimatike te

temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%. Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e rreshjeve pritet të rritet me 53%. Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:

- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;
- Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;

Dëbora në Ultesirën Perëndimore vrojtohet rrallë dhe ajo mendohet si dukuri e jashtëzakonshme. Mesatarisht gjatë një viti vrojtohen 1-2 ditë me dëborë.

Mjegulla formohet kryesisht gjatë periudhës së ngrohtë të vitit. Numri i ditëve me mjegull është mesatarisht rreth 70 ditë/në vit. Tensioni mesatar i avujve të atmosferës është 13.5mb, lagështia mesatare vjetore e ajrit është 74%, ndërsa defiqiti mesatar vjetor i lagështisë është rreth 5.5mb.

Vranësira

Mesatare vjetore e atmosferës është rreth 5.0 ball.

Tsunami

Në rastin e ndonjë tsunami dëmtime mund të ndodhin por shkatërrime të strukturës nuk do të ketë.

2.7 Drita

Drita konsiderohet si një nga resurset më të rëndësishme dhe të pashtershme që ka planeti ynë. Territorët e bashkisë Durrës gjenden në gjerësitë mesatare (midis 41° 36' 35" dhe 41° 16' 30" gjerësi gjeografike veriore), për rrjedhojë rrezatimi ditor, mujor dhe vjetor ka vlera të larta. Në mënyrë të veçantë, territorët e këtyre bashkive marrin sasinë më të madhe të energjisë diellore krahasuar me të gjitha bashkitë e tjera të vendit, që gjenden në të njëjtat gjerësi gjeografike apo edhe në gjerësi më të vogla. Sipas të dhënave të Institutit Meteorologjik Shqiptar, sasia e mundshme vjetore e rrezatimit të përgjithshëm, për kushtet e motit pa vranësira është 192.38 kkal/cm² 82. Kjo energji, e përfituar nga energjia e drejtpërdrejtë dhe e shpërndarë ka karakter të qëndrueshëm, pavarësisht se mund të ndryshojë në periudha të ndryshme të vitit. Ndryshueshmëria e rrezatimit diellor është më e madhe në periudhat ekstreme (verë-dimër, pranverë-vjeshtë). Vlerat më të larta të rrezatimit të përgjithshëm i ka muaji qershor, me 23.45 kkal/ cm² , ndërsa vlerat më të ulta muaji dhjetor, me 7.18 kkal/ cm² 83 . Duke analizuar këto vlera kuptojmë se në muajin qershor territorët e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut marrin rreth 3 herë më shumë energji diellore të përgjithshme për kushte të motit pa vranësira. Kjo lidhet me zgjatjen më të madhe të ditës, me solsticin e verës dhe këndin më të vogël të rënies së rrezeve të diellit. Sasi energjie diellore të përafërta me muajin qershor, territorët e Durrësit dhe të Shijakut, marrin në muajt maj (22.82 kkal/ cm²), korrik (23.12 kkal/ cm²) dhe gusht (21.07kkal/ cm²) 84. Për vlera të vogla të rrezatimit diellor dallohet muaji nëntor (9.18 kkal/ cm²), janar (8.16 kkal/ cm²) dhe shkurt (10.96 kkal/ cm²), e cila shkaktohet nga pjerrësia më e madhe rrezeve të diellit dhe sasia e vogël e orëve me dritë. Në muajt e tjerë sasia e energjisë diellore që vjen është midis vlerave 13-20 kkal / cm² ashtu siç tregohet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Vend-ndodhja	Muajt												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	8.16	10.96	16.59	19.74	22.82	23.45	23.12	21.07	17.18	12.93	9.18	7.18	192.38

Tabela 4. Sasia e mundshme mujore e vjetore e rrezatimit të përgjithshëm (kkal /cm²) (për kushte moti pa vranësira) *Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar Viti 2016*

2.8 Era dhe drejtimi i saj

Drejtimi i erës në territoret e Durrësit dhe të Shijakut është i ndryshueshëm. Rastisjen më të madhe e kanë erërat e kuadratit të veriut dhe më pas vijnë ato të kuadratit të jugut. Një rastisje më të vogël kanë erërat perëndimore dhe lindore, të cilat krijohen jashtë kufirit të vendit tonë me përjashtim të erërave lokale, si puhitë detare dhe tokësore. Erërat veriore nga pikëpamja termike janë erëra të ftohta (quhen edhe lëvizje zbritëse) pasi fryjnë nga gjerësitë më të mëdha drejt gjerësive më të vogla gjeografike, pra nga poli në drejtim të këtyre territoreve. Prej erërave të kuadratit të veriut mbizotëron veriu (27.8%) dhe veriperëndimi (8.5%) .Erërat jugore fryjnë gjithë të vitin kalendarik. Ato janë erëra të ngrohta dhe nga ky kuadrat mbizotëron juglindja (21.9 %). Këto erëra quhen ndryshe lëvizje ngjitëse, pas fryjnë nga gjerësitë më të vogla drejt gjerësive më të mëdha gjeografike. Erërat e kuadratit lindor janë shumë pak prezente në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, duke rastisur vetëm në 3.8% të vitit. Erërat perëndimore janë më prezente në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si rezultat i ndyshitimit termik midis sipërfaqes së tokës dhe sipërfaqes së ujit të detit Adriatik. Nëpërmjet tabelës së mëposhtme është ndërtuar grafiku, i cili paraqet trendafilin vjetor të erës.

Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
Durrës	6.2	27.8	4.3	3.8	21.9	7.6	6.6	13.3	8.5

Tabela 5. Shpërndarja vjetore e drejtimit të erës % *Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar Viti 2016*




Figure 7. Trendafilin e erës

Stinët	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë	Mes.Vjetore
Durrës	4.6	3.9	3.3	3.7	3.8

Tabela 6. Mesatarja e shpejtësisë së erës sipas stinëve

Duke ju referuar tabelës së mesipërme shpejtësia mesatare në stinën e dimrit është 4.6 m/s, ndërsa mesatarja vjetore 3.8 m/s.

2.9 Cilesia e mjedisit

2.9.1 Cilesia e ajrit ne zone

Cilesia e ajrit ne ne zonen e Projektit kondicionohen, nga dy faktore: ndertimet urbane dhe emetimet nga makinat.

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO₂, Nox, NH₃ dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse , ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zëmër dhe mushkrive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojnë sistemin nervor qëndror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.




Figure 8. Vlerat mesatare vjetore të PM10

Në grafikun nr.8 janë dhënë vlerat mesatare vjetore të PM10 në 3 stacione monitorimi, 2 stacione në Tiranë dhe nga 1 stacion në Durrës. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkallim të vlerës kufi të BE prej 40µg/m³ në tre stacione monitorimi në stacionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë Mjedisit nw Tirane. Të 2 stacionet jane stacione me burim ndotje trafikun ku numri i makinave që qarkullojnë në rrugët pranë stacioneve është shumë i lartë. Në stacionin e AKM në ndotjen e ajrit nga PM10 përveç shkarkimit të automjeve ndikon edhe pluhuri i rrugëve dhe ndërtimet. Vlera më e lartë ditore është monitoruar në muajin Prill dhe është 142.55 µg/m³ nga 50 µg/m³ që është standarti ditor i BE.

Problematike mbetet numri i ditëve që tejkallon standartin ditor të BE-së (50 µg/m³) në 4 stacione: në stacionin e Tirana AKM numri i ditëve të tejkaluara nga 35 ditë të lejuara është 190%, në stacionin e Tirana MM numri i ditëve të tejkaluara është 77%. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen numri i ditëve që tejkallon standartin ditor të BE-së.

PM10 (ditore)	Numri i diteve te tejkaluar	Numri i diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkallim	35

Tabela 7. Numri i ditëve që tejkallon standartin ditor të BE-së. Standarti i BE-së = 50 µg/m³.

2.9.2 Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Monitorimi realizohet në 34 stacione, në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bune, Mat, Ishëm, Erzen, Seman dhe Vjose duke perfaqësuar gjithë gjatësinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, në rrjedhjen e mesme dhe në rrjedhjen e poshtme. Monitorimi është realizuar me frekuence 4 here në vit për ujërat e lumenjve dhe të zonës bregdetare dhe 3 here në vit për ujërat e liqeneve. Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Vlerësimi i cilësisë së tyre përcaktohet në baze të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktiven Kuadër të Ujit të BE.

Parametrat e monitoruar janë-Temperatura, pH, alkaliniteti, saliniteti, percjellshmeria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO₅, nitritet, nitratet, amoniaku, P_{total}, PO₄, lënda pezull.

Interpretimi i rezultateve të monitorimit

Cilësia e ujërave të lumenjve bazohet në vlerat e rezultateve analitike të tete parametrave kryesore të ndotjes kimike të përcaktuara në Direktiven Kuadër të Ujit të BE. Sipas kësaj Direktive, ujërat e lumenjve klasifikohen në pese klasa, ku gjendja e moderuar ose klasa e trete, konsiderohet si klasa me nivelin minimal të pranueshem të cilesise së ujerave të lumenjve.

Temperatura mesatare vjetore në ujerat e lumenjve të monitoruar varion në vlerat nga 13.9-20.6 °C dhe përputhen me ndryshimet sezonale natyrore. Në rrjedhjen tyre të sipërme ujërat e lumenjve karakterizohen nga një vlere e ulët e temperaturës, pasi janë ujëra të cilët vijnë nga zonat malore. Në krahasim me një vit më parë nuk kemi ndryshime në ecurinë vjetore të temperaturës së ujërave të lumenjve.

Ujërat e lumenjve tanë vlerësohen alkaline me pH nga 7.5-8.3 dhe në vlera brenda normës së lejuar (< 8.5)

Përmbajtja e alkalinitetit të përgjithshëm rezulton në vlera më të larta në lumin e Gjanicës, dhe në lumin Drinit të Lezhës. Vlerat e këtij parametri kanë luhatje vjetore pothuajse të njëjtë për të gjithë stacionet e lumenjve të tjere.

Percjellshmeria elektrike në vlera më të larta rezulton në stacionet e lumit Ishëm, në stacionin Sallmone të lumit Erzen, në lumin e Gjanicës dhe në Seman në zonën e Mujallise, pas bashkimit me lumin e Gjanicës.

2.9.3 Cilësia e ujërave të lumenjve

Baseni Ishem-Erzen


Monitorohet në 11 stacione. Lumi i Ishmit ka 7 stacione monitorimi të vendosura në rrjedhen dhe në degëzimet kryesore të tij. Lumi i Tiranës monitorohet në stacionet Ura e Brarit dhe ura e Kamzes, lumi i Lanës në Lanabregas dhe në ish doganen, lumi i ishmit ne uren e Rinasit, Gjoles dhe ne uren Salmer ne Ishem.-Stacionet e këtij lumi janë nën ndikim të plotë të shkarkimeve urbane dhe industriale të zonës ku kalon ky lum dhe me një presion mjaft të lartë në krahasim me stacionet e tjera të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore të vendit. Lumi Erzen monitorohet ne 3 stacione, Pellumbas, Ndroq dhe Sallmone.

Përmbajtja e oksigjenit të tretur

Baseni Ishem-Erzen

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet një situatë e ndryshme e cila ndryshon nga stacioni në stacion për sa i përket vlerës së oksigjenit të tretur. Stacionet reference, Ura e Brarit (T1) dhe Lanabregasi (L1) janë me të pasur me oksigjen dhe variojnë nga 8.96 -9.01 mg/l. Ka një sasi të pakët të oksigjenit në stacionin L2 (ish dogana) ku lumi i Lanës paraqitet në gjëndje të varfër klasa e IV e cilësisë së ujërave, si pasojë e shkarkimeve urbane të qytetit të Tiranës. Në tre stacionet e lumit Ishëm vlera e oksigjenit të tretur është pothuajse konstante nga 3.6-4.6 mg/l dhe klasifikohen të cilësive së trete, gjëndje e moderuar.

Tre stacionet e lumit Erzen rezultojnë të pasura me oksigjen dhe klasifikohen të cilësive së parë, ku vërejmë stacionin reference me përmbajtje me të lartë 9.95mg/l.




Përmbajtja e nevojës biologjike për oksigjen

Baseni Ishem-Erzen

Në basenin Ishem-Erzen, paraqitet një situatë me problematike për sa i përket përmbajtjes së NBO₅. Siç shihet edhe nga grafiku në stacionin Yrshek (L2) kemi vlerat më të ulta të këtij parametri dhe klasifikohet i cilësive së mirë, Lanabregasi i cilësive së trete, gjëndje e moderuar. Në dy stacionet T2 –ura Kamez dhe L2- tek ish dogana, që ndodhen pas shkarkimeve të ujërave urbane të patrajtuara të qytetit të Tiranës, përmbajtja e NBO₅ rritet në vlera shumë të larta, duke tejkaluar dhe nivelin e cilësive më të keqe, klasa e peste. Situata paraqitet problematike edhe në tre stacionet e lumit Ishëm të cilët paraqiten në gjëndje të keqe, cilësi e peste dhe të katër për stacionin e fundit në Ishëm. Shkaqet për këtë gjëndje janë shkarkimet e lëngëta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve të zonës së autostradës.

Në tre stacionet e lumit Erzen përmbajtja mesatare e NBO₅ rezulton në 7-10-12-mg/l përkatësisht në stacionin Pellumbas ujërat janë të cilësive së mire, ndërsa në stacionet ura Beshirit dhe Sallmone vlerësohen më të ndotura të cilësive së trete, gjëndje e moderuar.

Përmbajtja e NBO5



Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen


Baseni Ishëm-Erzen

Situata paraqitet problematike në basenin Ishëm-Erzen, sidomos në lumin e Ishmit. Siç shihet edhe nga grafiku problematik mbetet lumi i Tiranës në stacionin Ura e Kamzës, lumi i Lanës në stacionin L2 (ish dogana) që ndodhen pas kolektorëve të ujërave urbane të patrajtuara të qytetit të Tiranës ku niveli i ndotjes është mjaft i lartë, T2- ura Kamez 52 mg/l dhe L2- tek ish dogana 138 mg/l.


Situata është e njëjte edhe në tre stacionet e lumit Ishëm ku përmbajtja e NKO paraqitet në vlera të larta, nga 35-34 mg/l. Shkaqet për këtë gjëndje janë shkarkimet industriale dhe urbane të patrajtuara.

Në tre stacionet e lumit Erzen përmbajtja mesatare e NKO rezulton me rritje graduale nga stacioni reference Pellumbas në dy stacionet e tjere , ura Beshirit dhe Sallmone në vlera 12-17-22-mg/l ku verehet një rritje e vogël në stacionin e fundit.

Përmbajtja e NKO



Permbajtja e fosforit total




Baseni Ishëm-Erzen rezulton me përmbajtje të lartë të fosforit, sidomos në lumin e Ishmit. Siç shihet edhe nga grafiku në stacionet reference, ura e Brarit për lumin e Tiranës (T1) dhe Lanabregasi për lumin e Lanës përmbajtja mesatare e fosforit total varion nga 0.028-0.19 mg/l që vlerësohen me një gjëndje shumë të mirë.

Në dy stacionet e tjera T2 –ura Kamez dhe L2- tek ish dogana, që ndodhen pas shkarkimit të kolektorëve të ujërave urbane të patrajuara të qytetit të Tiranës, përmbajtja e fosforit total rritet në vlera shumë të larta, 0.33 mg/l në stacionin T2 dhe 1.8 mg/l në stacionin L2. Si rrjedhojë cilësia e ujerave të lumit të Tiranës dhe të lumit të Lanës në këto stacione përkeqësohet duke u klasifikuar në cilësinë më të ulët, të varfer - në të keqe.

Situata është e njëjtë edhe në tre stacionet e lumit Ishëm ku përmbajtja e fosforit paraqitet në vlera të larta, nga 0.5-1.6 mg/l duke i klasifikuar në një gjëndje të varfer. Shkaqet për këtë gjëndje janë shkarkimet e lengeta urbane të patrajuara që përmbajnë tretësira detergjentesh me përmbajtje fosfori, ende në përdorim nga shumë përdorues familjare dhe industrial.

Në tre stacionet e lumit Erzen përmbajtja mesatare e fosforit total rezulton në 0.019-0.036-0.058 mg/l përkatësisht në stacionet Pëllumbas, ura Beshirit dhe Sallmone, duke i vlerësuar të cilësisë shumë të mirë.




Situata paraqitet me problematike për NO2 në basenin Ishëm-Erzen, sidomos në lumin e Ishmit. Siç shihet edhe nga grafiku në stacionet reference, ura e Brarit për lumin e Tiranës (T1), dhe Yrshek ish dogana për lumin e Lanës (L2) përmbajtja mesatare e NO2 varion nga 0.001-0.026 mg/l që vleresohen me një rritje por brenda vlerës limite.

Situata është e njëjtë edhe në tre stacionet e lumit Ishëm ku përmbajtja e NO2 paraqitet në vlera pak me të larta, nga 0.032-0.049-0.01 mg/l, këto vlera ndodhen brenda normës së lejuar.

Në tre stacionet e lumit Erzen përmbajtja mesatare e NO2 rezulton në 0.005-0.005-0.018-mg/l përkatësisht në stacionet Pëllumbas, ura Beshirit dhe Sallmone, duke i vlerësuar këto ujëra si ujëra të një cilësie shumë të mirë.

Permbajtja e amoniakut




Në këtë basen paraqitet dhe situata me problematike përsa i përket vlerave të NH₄ në krahasim me basenet e tjera. Siç shihet edhe nga grafiku pellgu i lumit Ishëm paraqitet me nivelin me të larte ndotës për përmbajtjen e NH₄ në pese stacionet nga shtatë të monitoruara, si pasojë e shkarkimeve të ujërave urbane të patrajtuara që derdhen n dy deget kryesor , lumi i Tiranës dhe i Lanës, si dhe të ujërave të përdorura të zonës industriale t Tiranës. Përvec stacionit reference, ura e Brarit, që klasifikohet i cilësise së dyte dhe të Lanabregasit të

cilësise së trete stacionet e tjera vleresohen me nivelin më të larte ndotës dhe klasifikohen në gjendjen më të keqe. Përmbajtja mesatare e NH_4 varion nga 3.5-9.8 mg/l duke tejkaluar disa here normen e gjendjes se moderuar, cilësine e trete. Vlera me e larte paraqitet në lumin e Lanës tek Ish dogana që ndodhet pas shkarkimit te kolektoreve të ujërave urbane, të cilat janë përgjegjese direkte për vlerat e larta të përmbajtjes se amonjakut .

Në tre stacionet e lumit Erzen përmbajtja mesatare e NH_4 rezulton ne 0.050-0.41-0.34-mg/l përkatësisht në stacionet Pëllumbas, ura Beshirit dhe Sallmone, të cilët klasifikohen respektivisht të cilësisë së pare, të trete dhe të dytë. Në dy stacionet e fundit kemi rritje të përmbajtjes se amonjakut pasi ujërat e lumit i Erzenit kalon afer zonave të banuara dhe është nën presionin e shkarkimeve urbane të pa trajtuara

Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet rezulton në vlera me të ulta se norma e lejuar të cilësise shume të mire, < 0.8mg/l.Përfundim bën vetem stacioni i lumit Gjanice ku kemi dhe vleren më të larte 1.26 mg/l.




2.9.4 Klasifikimim i cilësisë së ujërave të lumenjve.

Nga krahasimi i rezultateve mesatare të monitorimit për vitin 2015 me vlerat limite të përcaktuara sipas DKU të BE, në tabelën e mëposhtme jepet vlerësimi në klasa i cilësisë së ujërave te lumenjve në 34 stacionet e monitoruar.

Klasifikimi i cilësisë së ujërave të lumenjve sipas stacioneve

Klasifikimi	Clësia I	Clësia II	Clësia III	Clësia IV	Cleësia V
Stacionet	2 stacione 5.9%	12 stacione 35.3%	12 stacione 35.3%	1 stacione 2.9%	7 stacione 20.6 %



Si tregon edhe grafiku 41% e stacioneve të monitoruara janë të cilësisë shumë të mirë –te mire, 35 % të cilësisë së III ose gjëndje e moderuar dhe 24% të cilësisë së IV-V ose gjëndje e varfër –gjëndje e keqe.

Klasifikimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bazuar në DKU të BE

Cilësia	Mat Vjose	Drin, Buna Erzen Shkumb Seman	D.Lezhe	Ishem	Gjanice	Ne %
I						0%
II	II					20%
III		III				50%
IV			IV			10%
V				V	V	20%

2.9.5 Niveli i zhurmave te zones

Udhëzimi i perbashket i Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministri i Shëndetsisn.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, percakton vlerat kufi te zhurmave, sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Duhet theksuar se ne afersi te zones se objektit nuk ka qendra te banuara

Tabela nr.16: Nivelet kufi te zhurmes per mjedis te caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
Zona me aktivitetet social-ekonomik				

Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, industri dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët □ 5 herë/vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 □ 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140 □2 120 □2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	□3		

Shpjegime:

Laeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

Lamax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

□ 1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

□ 2 = Presioni zanor maksimal (Lamax, fast) matur 100 mm larg veshit.

□ 3= Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

□ 4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

2.9.6 Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane përbën një nga problemet më të mprehta në Shqipëri. Politikat në fushën e mbetjeve synojnë përmirësimin e administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor dhe mjedisor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të KE.

Progres më i dukshëm në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane është bërë në drejtim të legjislacionit. Gjatë viteve 2005 – 2012 legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje te reja, vendime dhe rregullore/udhëzues që reflektojnë direktivat/vendimet e KE dhe kërkesat e Konventës së Bazelit.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operacionale me nga 5 vjet secila. Objektivat e kësaj draft strategjie janë:

- Deri në vitin 2015 synon riciklimin/ kompostimin e 25% të mbetjeve bashkiake;
- Deri në vitin 2020 synon të ndalojë rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% të mbetjeve bashkiake;
- Deri në 2025: Rikuperimin e energjisë nga 15 % e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake në lëndfill nga 90% që është aktualisht, në rreth 30%;

Niveli i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është i ulët. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane ofrohet në shumë qytete, por jo në zonat rurale. Mbetjet depozitohen në vendgrumbullimet e përacktura nga bashkitë. Depozitimi i tyre bëhet shesht e depozitimit, të cilat nuk plotësojnë parametrat e duhura për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve. Ky menaxhim i dobët i mbetjeve përmes hedhjes së tyre së bashku pa ndonjë ndarje dhe trajtim në vend-depozitim shkakton emëtime të ndotësve në ajër dhe ujë. Në komunitet më të vogla nuk sigurohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve dhe individët janë përgjegjës për largimin e mbetjeve të tyre. Kjo shpesh rezulton në hedhjen pa kriter të mbetjeve përgjatë rrugëve, lumenjve dhe djegien e tyre në mjedis të hapur.

Rikuperimi, ri-përdorimi dhe riciklimi i mbetjeve është mjaft i kufizuar. Sistemi i grumbullimit të mbetjeve për biznesin ricikluar është organizuar në mënyrë informale.

Deri tani, megjithëse është pranuar me ligj, mbetjet e rrezikshme hidhen në te njëjtat vende me mbetjet jo të rrezikshme. Paketimi dhe etiketimi i tyre nuk vihet në praktike, megjithëse legjislacioni e parashikon këtë.

3 IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**o Metodologjia**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarisë, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e Perbersve të Mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne pejsazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Shkarkimet e lengeta
- Ndikimi ne flore/ faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi i tyre
- Ndikime socio-ekonomike
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor

○ **Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne faze te ndertimit te objektit**

Ndikimet me te medha ne mjedis per shkak te zbatimit te projektit mendohet te jene:

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
Pejsazhi	Ndryshim i pejisazhit te zones	Gjate fazes se ndertimit e gjithe zona do te rrethohet me me rrjeta dhe me tabela si per mbrojtjen e punonjeseve ashtu dhe per kalimtarete e zones qe mund te kalojne.
Toke	Ngjeshje e tokes	Si pasoje e levizjes se makinerive ne kantier, do te kemi ngjeshje te tokes ne sektore te vecante te saj. Mund te kemi ndotje eventuale te tokes nga derdhje aksidentale te lubrifikanteve/ karburantit te makinerive.
	Erozion i tokes	Si pasoje e operacioneve ndertimore dhe pershtatjes se sheshit te ndertimit do te realizohen punime germuese per hapjen e themeleve si pasoje e te cilave do te gjenerohet nje sasi e konsiderueshme dherash, dhe mbetje inerte te cilat kerkojne vemendje te vecante
	Ndotje e tokes	Gjate fazes se ndertimit, do te kemi sjelljen e lendes se pare si cemento, koll etj. Nuk pritet te kete ndotje te tokes pasi dhe pjesa e llacit dhe te gjitha do te behen me makineri bashkekohore dhe automatike.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Gjate fazes se ndertimit, mund te ndodhe qe te kete shpelarje te lendes se pare nga shirat. Keshillohet qe lendet e para te vendosen ne vende te thata dhe te mbuluara ne menyre qe te mos kete ndotje te ujerave siperfaqesore.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Nuk pritet ndikim ne cilesine e ujerave nentokesore.

Ajer	Emisione gazesh	Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. <ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi i gjeneratorit. - Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare transportojne produktin perfundimtare, mjetet e marrin mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve
	Aromat	Faza e ndertimit nuk shoqerohet me aroma te renda dhe bezdisese, si per punetoret ashtu dhe per banoret e zonave perreth.
	Zhurme, vibrime	Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate transportimit te produkteve. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise. Megjithate ndertimi mund te shkatoje stres minimal ne floren dhe faunen e zones. Theksojme se zona nuk ka nje flore dhe faunen te mbrojtur me ligj.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones	Gjate Fazes se ndertimit nuk do shkaktohen shqetesime te banorve perreth pasi do merren masat e nevojshme per eleminimin e tyre..
Menaxhimi i mbetjeve	Ndikim ne mjedisin e zones	Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i shoqerise vleresohet te jene mbetje inerte dhe mbetje urbane si kartona, qese dhe ambalazhe te lendes se pare qe sherben per ndertimin e kompleksit. Ato do te mblidhen ne fund te dites se punes dhe do te cohen ne vendet e percaktuara nga Pushteti Vendor
Ndikimet tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones. Keshillohet te punohet ne orare te cilat mos sjellin shqetesime per banoret dhe trafikun.
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Gjeneratori qe funksionon me djegie te naftes do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.
	Siguria dhe ndikimet ne shendet	Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Investitori ka ne stafin e tij dhe nje mjek patolog i cili realizon konsulta periodike.
	Ndikime social-ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsis se zones nga punesimi, rritja e eksporteve te produkteve vendase dhe rritja e nivelit te taksave qe paguan shoqeria.

- **Mbetjet e ngurta nga germimet dhe inerte**

Mbetjet e dala nga germimet do te depozitohen ne zonen anash ndertimit dhe do te perdoren si mbushes gjate fazes se ndertimit. Pjese tjeter do te sistemet ne venddepozitimet e caktuara nga Pushteti Vendor me nenkontraktor te trete qe cilet duhet te jene te licensuar per transportin e ketyre mbetjeve. Per sa i perket mbetjeve inerte, ata jane ne sasi te pakonsiderueshme pasi vete aty nuk ka ndertime, por sera te cilat eshte bere nje zhvendosje e tyre.

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet e kartonave dhe plastikave grumbullohen dhe me pas do te dergohen ne vendet e percaktuara nga Njesia Vendore.

Sipas ligjeve shqiptare (Per menaxhimin e integruar te mbetjeve), subjekti qe kryen menaxhimin e ketyre mbetjeve duhet te pasjiet me leje mjedisore dhe me license per plotesimin e kushteve dhe kriterëve per menaxhimin ne menyre te integruar te tyre.

Subjekti gjate aktivitetit te tij nuk gjeneron mbetje te rrezikshme

- **Emisionet e gazeve dhe te pluhurit ne ajer**

Ne aktivitetin i ndertimit te kompleksit mund te percaktohen keto pika shkarkimi ne ajer:

- a. Shkarkimi i gazeve NO_x, SO₂, CO nga gjeneratori me kapacitet 500 W
- b. Shkarkimi i gazeve NO_x, SO₂, CO nga mjetet e transportit
- c. Shkarkimi i pluhurit nga levizja e mjeteve te transportit te lendeve te para

Kantieri do laget vazhdimisht per te minimizuar nivelin e pluhurit te emetuar ne atmosfere nga levizja e mjeteve te transportit. Mjetet e transportit do te kontrollohen periodikisht dhe do te mirembahen per te patur shkarkime minimale.

- **Emisionet nga trafiku i automjeteve**

Në bazë të minimumit të vlerësuar prej 3 kamionash ne dite që do të përdoren për transportimin e lendes se pare dhe produktit perfundimtar, ne kemi llogaritur vlerat totale të ndotësve të ajrit që do të shkarkohen prej tyre në mjedisin rrethues. Llogaritjet janë bazuar në Estimated Emission Factors for Diesel Heavy Duty Vehicles, table 7.12

Po japim më poshtë pjesën e tabelës që na intereson:⁵

Shkarkimi	NO _x	NH ₃	VOC	CO	N ₂ O	PM 2.5	CO ₂
Total g/km	7.43	0.003	0.534	0.034	0.030	0.011	0.486

Faktorët e shkarkimit për kamionat që punojnë me naftë (3.5 – 16 t)

Sipas saj, shkarkimet ditore nga trafiku rrugor, duke marrë 30 km rrugë ne ditë në zonën që na intereson (ose 30 km/ditë për 3 kamiona/ditë) do të jenë:

Shkarkimi	NO _x	NH ₃	VOC	CO	N ₂ O	PM 2.5	CO ₂
-----------	-----------------	-----------------	-----	----	------------------	--------	-----------------

⁵ EMEP/EEA air pollutant emission inventory guidebook 2016 - Emission factors

Total g/km	7.43	0.003	0.534	0.034	0.03	0.011	0.486
km	30	30	30	30	30	30	30
Total g/3kamion	222.9	0.09	16.02	1.02	0.9	0.33	14.58
Total kg/3kamion/dite	0.2229	0.0001	0.0160	0.0010	0.0009	0.0003	0.0146

Tabela 8: Shkarkimet ditore nga trafiku rrugor

KAPITULLI IV

4 MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- **Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore**

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate Sistemim asfaltim rruga lagjes Rubjeke Njesia Administrative Maminas

Bashkia Shkozet duhet te marren masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit qe do te merren ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore - Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar - Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit - Perdorimi i naftes D1 per kamionet transportues dhe autobetonieret. - Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj - Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithe teknologjise se projektit, sistema i qarrkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione; - Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash - Kompaktesim dhe lagje e inerteve ne qiell te hapur - Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier - Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij - Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes, sipas nevojës. - Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulese me polietilieni
	- Riparim i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike

Nderhyrje	- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rsat emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambluanca)
Administrim	- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

○ **Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit**

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)	Mjetet e transportit duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses, mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri.
2	Emetim gazesh nga automjetet qe do kryejne punimet	Kontroll te vazhdueshem dhe mirembajtje te gjendjes teknike te pajisjeve
3	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen tubat e shkarkimet te gazeve te mjeteve te cilet ne rast se cahen apo demtohen guarnicionet emetojne zhurma mbi nivlelet teknologjike te tyre. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve.
4	Shtim i trafikut rrugor	Te organizohet levizja e mjeteve kur hyne dhe dalin nga kantieri ne menyre te tille qe mos te krijone veshtiresi ne trafikun rrugor. Rekomandohet te drejtohen automjetet nga dalja e kantierit ne menyre te tille per shmangien e aksidenteve.

○ **Menaxhimi i shkarkimeve te gazta**

Do te kontrollohen ne menyre periodike gjendja teknike e mjeteve te transportit, e gjeneratorit. Nese shkarkimet e tyre nuk jane brenda normave do ti nenshtrohen riparimit. Gjithashtu edhe gjeneratori do te monitorohet ne menyre periodike per shkarkimet e gazeve dhe nese clirimi i gazeve eshte me i larte se norma do ti nenshtrohet remontit.

○ **Masat rehabilituese ne perfundim te aktivitetit**

Ne perfundim te aktivitetit te kantierit te ndertimit do te cmontohen te gjitha pjeset e kantierit dhe do te largohen te gjitha mjetet dhe pajisjet ndihmese.

○ **Masat per minimizimin e ndikimit ne trafikun e zones**

Kantieri do te marr persiper te organizoje levizjen e mjeteve te transportit ne menyre te tille qe te mos shkaktoje rendim ne trafikun e zones. Te organizohet hyrja dhe dalja nga kantieri per ne rruge.

○ **Trajnimi dhe Ndergjegjesimi**

Shoqeria duhet te kryej trajnime te stafit ne lidhje me:

- Sigurine ne pune

- Ruajtje te kushteve higjiene-sanitare
- Trajnim mbi kushtet dhe problematikat e ndotjes se mjedisit nga aktiviteti
- Veprimet qe duhet te ndermerren ne raste te ndotjes aksidentale
- Perballimi i situatave te zjarrit dhe perdorimi i ekstintoreve
- Trajnim mbi ndihmen e pare

Cdo person shtese i stafit duhet te trajnohet per ceshtjet e mesiperme.

○ **Programi i monitorimit dhe elementet e tij**

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorim parametrave fiziko –kimike i ujit te perdorur para shkarkimit	Cdo 3 muaj	<u>Analize e plote.</u> pH, Lenda pezull BOD ₅ COD
2	Monitorimi i menaxhimit te mbetjeve te aktivitetit	Çdo 3 muaj	Kontroll mbi rregjistrimin, depozitimi dhe transportimin dhe kontratat me shoqerite ricikluese/riperdoreuese
3	Monitorimi i zhurmes se shkaktuar	Periodik (raportim cdo 3 muaj)	Zhurma db(A) nga aktiviteti i impiantit ne 8 pika ne rrethim te kantierit.

* Cdo parameter dhe ndikim qe mund te identifikohet nga aktiviteti mund te shtohet si parameter per tu monitoruar

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin e ndertimit e industriale u pergatit nga eksperti mjedisor Elvis Xhaferri te studios per konsulence mjedisore Qendra e Monitorimit te Mjedisit

Eksperti Mjedisor

MSC.Ing. Elvis XHAFERRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 5108 Prot.

Tiranë, më 08.07. 2013

Nr. identifikues 151

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ELVIS XHAFERRI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për plane mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Fatmir MEDIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-0402-11-2015 NUIS/NIPT: K92402036A
 Subjekti: QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT
 Adresa: TIRANE, TIRANE, Tirane, Rruga "Mujo Ulqinaku", Njësia Nr.10,
 Pallati Teknoprojekt
 Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:
 Data e lëshimit: 11/11/2015 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë
 Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor,
 Ndikim në mjedis)

Kufizime specifike
 Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike
 Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë
 Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Kategoria
 Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria
 Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike
 1. Ndikim në mjedis
 2. Auditim mjedisor

Specialiteti



Nënshtkrimi i sportellit: *Daridlo*